



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 27 qershor 2022
Nr. ref.: RK 2015/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI197/21

Parashtrues

Mazllum Belegu

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev. nr. 166/2021 të 29 qershorit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Mazllum Belegu nga Peja (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës). Parashtruesin e kërkesës e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve „Vokshi & Lata“ me avokatët Adem Vokshi dhe Florin Lata nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) Rev. nr. 166/2021 të 29 qershorit 2021.
3. Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 13 gusht 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenet 6 [E Drejta për një proces të rregullt] dhe 1 [Mbrojtja e pronës] të Protokollit nr. 1. të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 3 nëntor 2021, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) pranoi kërkesën e parashtruesit.
7. Më 5 nëntor 2021, Gjykata njoftoi përfaqësuesit e parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 8 nëntor 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Safet Hoxha (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
9. Më 19 janar 2022, Gjykata i dërgoi një shkresë përfaqësuesve të parashtruesit të kërkesës, përmes së cilës kërkoi që t'i ofrojnë Gjykatës dëshmi se kur aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme i ishte dorëzuar parashtruesit ose atyre si përfaqësues ligjorë.
10. Më 21 janar 2022, përfaqësuesit e parashtruesit të kërkesës i dërguan shkresë Gjykatës duke e njoftuar atë se ata nuk e kanë fletëkthesën dhe se Gjykata ta kërkonte zyrtarisht nga Gjykata Themelore dëshminë e dorëzimit të aktgjykimit të kontestuar.
11. Më 8 shkurt 2022, Gjykata i dërgoi një shkresë Gjykatës Themelore duke kërkuar që Gjykatës t'i dorëzohet fletëkthesa kur aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës ose përfaqësuesve të tij ligjorë.

12. Më 10 shkurt 2022, Gjykata Themelore dërgoi dëshmi në Gjykatë, nga e cila mund të konkludohet se aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 13 gusht 2021.
13. Më 10 gusht 2022, Gjykata i dërgoi një shkresë të re përfaqësuesve të parashtruesit të kërkesës, përmes së cilës kërkoi dokumente shtesë, si dhe sqarime të pretendimeve në kërkesë.
14. Më 21 shkurt 2022, përfaqësuesit e parashtruesit të kërkesës i dërguan dokumentet dhe në shkresë dhanë sqarimin e kërkuar nga Gjykata.
15. Më 22 mars 2022, Gjykata i dërgoi një shkresë Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) përmes së cilës kërkoi që t'i dorëzohen të gjitha shkresat e lëndës.
16. Më 28 mars 2022, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë shkresat e kërkuara të lëndës.
17. Më 7 prill 2022, Gjykata u dërgoi një shkresë shtesë përfaqësuesve të parashtruesit të kërkesës, me pyetjen në vijim; *"A keni dorëzuar përgjigje në revizionin e parashtruar nga Komuna e Prishtinës në Gjykatën Supreme, nëse po, ju lutemi të na dorëzoni"*.
18. Më 15 prill 2022, përfaqësuesit e parashtruesit të kërkesës dorëzuan përgjigje në Gjykatë në pyetjen e 7 prillit 2022. Gjykata do ta paraqesë përgjigjen e përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës në pjesën përkatëse të aktvendimit.
19. Më 9 qershor 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

20. Bazuar në shkresat e lëndës rrjedh se objekti i kontestit ka të bëjë me pjesën e ngastrës të cilën parashtruesi i kërkesës e ka fituar në bazë të kontratës nr. 697/80, të lidhur më 28 nëntor 1987 me Bashkësinë Vetëqeverisëse të Interesit për Qeverisje me Tokë Ndërtimore në Komunën e Prishtinës (në tekstin e mëtejme: BVI). Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës ka fituar një pronë të paluajtshme në shfrytëzim për shumën e paguar prej 4.810.300 dinarë, e cila është regjistruar si ngastra kadastrale nr. 851/8 në vendin e quajtur "Normalja", fleta poseduese nr. 9542, zona kadastrale Prishtinë, në sipërfaqe prej 0.04.28 ha. Parashtruesi i kërkesës në bazë të kontratës nr. 697/80 është regjistruar si bartës i së drejtës së shfrytëzimit të ngastrës kadastrale nr. 851/8 në sipërfaqe prej 0.04.28 ha, në Shërbimin Kadastral të Kosovës - Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë në Prishtinë. Mirëpo, problemi lind kur komuna e Prishtinës gjatë ndërtimit të rrugës ia merr një pjesë të parcelës që është objekt i kontratës nr. 697/80.
21. Duke pasur parasysh këtë, parashtruesi i kërkesës iu drejtua Komunës së Prishtinës me kërkesë *"që zënja e trollit t'i kompensohet: ose me para, duke kompensuar tërë sipërfaqen e trollit me çmime të tregut, ose duke i kompensuar sipërfaqen e zene me rruge, me një sipërfaqe tjetër"*, sepse për një gjë të tillë pala e paditur ka mundësi. Nga shkresat e lëndës rezulton se Komuna e Prishtinës nuk i është përgjigjur kërkesës së parashtruesit.

22. Më 15 maj 2007, parashtruesi parashtroi kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në të cilën ai nuk e deklaroi vlerën e kontestit, kundër Komunes së Prishtinës, në të cilën ai kërkoj që „Komuna e Prishtinës që paditësit si kompensim për trollin e zënë për ndërtim rruge, t'ia jep një sipërfaqe të njëjtë e cila i ngjitet pjesës që i ka ngelë paditësit në shfrytëzim duke krijuar një tanësi sipërfaqeje prej 0.04.28 ha (428 m2) dhe të lejojë që kjo sipërfaqe të evidencohet në libra kadastral si ngastër e paditësit, e tërë kjo në afat prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi bëhet i formës së prerë e me kanosje të përmbarimit”.
23. Më 27 maj 2009, Gjykata Komunale nxori Aktgjykimin C. nr. 1212/07 me të cilin e aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e parashtruesit dhe në pikën **I të dispozitivit** vërtetoi se paditësi (parashtruesi i kërkesës) „e ka të drejtën e shfrytëzimit të përhershëm të pjesës së ngastrës kadastrale nr. 851/1, në vendin e quejtur "Vreshta" zona kadastrale Prishtinë e në sipërfaqe prej 121 m2 nga baza e kompenzimit për paluajtshmërinë e shfrytëzuar për rrugë të lagjes, në pjesën lindore të ng. kad. Nr. 851/8, në vendin e quajtur "Vreshta", ZK-Prishtinë, në kufijtë e drejtë: prej pikës 1-2 në gjatësi prej 24.08 m, prej pikës 2-3 në gjatësi prej 15.01 m, prej pikës 3-4 në gjatësi prej 8.05 m, prej pikës 4-5 në gjatësi prej 13,20 m, prej pikës 5-6 në gjatësi prej 8.75 m dhe prej pikës 6-1 në gjatësi prej 16.32 m“.
24. Në arsyetimin e aktgjykimit, Gjykata Komunale deklaroi „[...] gjykata ka ardhur në përfundim se e paditura me ndërtimin e rrugës së lagjes, në vendin e quajtur "Vreshta" ka përfshire në rrugë sipërfaqen e lartcekur të ngastrës 851/8, ashtu që në mënyrë të dukshme ka zvogëluar paluajtshmërinë lëndore të destinuar si truall për ndërtim individual, me çka trualli i paditësit esencialisht ka humbur funksionin për të cilin është destinuar.
- [...]
- Rrjedhimisht duke pasur parasysh faktin se ngastra kadastrale nr. 851/1, pronë e të paditurës nuk ka ndonjë destinim të caktuar , gjykata konsideron se ekzistojnë kushtet që pjesa e ngastrës të marrur per rrugën e lagjes ti kompenzohet paditësit nga ngastra 851/1, pasi që me vetë aktin e marrjes së pjesës së ngastrës që i ka takuar paditësit, e paditura ka hyrë në detyrim ndaj të njëjtit, prandaj gjykata me të drejtë vendosi që ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësit, duke ia njohur atij të drejtën në shfrytëzim të pjesës së ngastrës kadastrale 851/1 në sipërfaqen prej 121 m2, që i është marrur. nga ngastra-trualli i tij për ndërtimin e rrugës së lagjes dhe ta detyroj të paditurën që paditësit t'ia njoh këtë të drejtë”.
25. E paditura Komuna e Prishtinës parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, duke pretenduar „shkelje të dispozitave të nenit 181, al. 1., pika a), b) dhe c) e LPK-së, me propozim që ankesa të miratohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi ankimor të priset dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim”.
26. Më 31 janar 2011, Gjykata e Qarkut nxori Aktvendimin Ac. nr. 1026/2009, përmes të cilit aprovoi si të bazuar ankesën e palës së paditur Komunes së Prishtinës dhe anuloi aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 1212/07 të 27 majit 2009 dhe ktheu çështjen në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.
27. Në arsyetimin e Aktvendimit Ac. nr. 1026/2009 Gjykata e Qarkut deklaroi:

„Nga shkresat e lendes rrjedhë se: gjykata e shkallës së parë lidhur me këtë çështje kontestuese nuk e ka zbatuar fare të drejtën materiale nga se aktgjykimin e saj nuk e ka mbështetur pothuajse në asnjë dispozitë ligjore, me përjashtim të dispozitës nga neni 452 i LPK-së e cila ka të bëjë me shpenzimet e procedurës, këtë sepse nuk është vërtetuar plotësisht fakti se paditësi në cilën periudhë e ka nënshkruar kontratën mbi dhënie të tokës urbane në shfrytëzim të përhershëm, ngase në shkresat e lëndës ekziston vetëm një kopje e kontratës e cila është administruar si provë, por nuk është bërë shiqimi në origjinalin e kësaj kontrate pasi në procesverbalin e shqyrtimit kryesor një gjë e tillë nuk është konstatuar. Në procesverbalin e administrimit të provave të dt. 27.05.2009 është lexuar kontrata mbi dhënie të tokës në shfrytëzim nr. 697/801-2 dt.28.09.2007, e në të cilën kontratë gjykata e shkallës së parë edhe e ka bazuar aktgjykimin e saj, ndërsa një kontratë e tillë mungon në shkresat e kësaj lënde. Në shkresat e lëndës ekziston vetëm kontrata e fotokopjuar nr. 697/80-2 e dt. 28.09.1987 e cila nuk është administruar si provë nga gjykata e shkallës së parë, ndërsa e paditura thirret në këtë kontratë të tillë”.

28. Më 4 korrik 2014, në procedurën e përsëritur Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin C. nr. 228/11, në të cilin në pikën **I të dispozitivit**, e aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e parashtruesit, në pikën **II të dispozitivit** përcakton se paditësi ka të drejtën e shfrytëzimit të përhershëm të një pjese të ngastrës kadastrale nr. 851/1, në vendin e quajtur “Normalja”, ZK Prishtinë, në sipërfaqe prej 121 m² nga baza e kompensimit për paluajtshmërinë e shfrytëzuar për rrugë të lagjes, në pjesën lindore të ngastrës kadastrale nr. 851/8, në vendin e quajtur “Vreshta”, ZK-Prishtinë, në kufijtë e drejtë: prej pikës 1-2 në gjatësi prej 24.08 m, prej pikës 2-3 në gjatësi prej 15.1 m, prej pikës 3-4 në gjatësi prej 8.5 m, prej pikës 4-5 në gjatësi prej 13,20 m, prej pikës 5-6 në gjatësi prej 8.75 m dhe prej pikës 6-1 në gjatësi prej 16.32 m, në pikën **III të dispozitivit**, detyron Komunën e Prishtinës t’ia njohë të drejtën paditësit nga pika 2 e këtij dispozitivi.

29. Në arsyetimin e Aktgjykimit C. nr. 228/11 Gjykata Themelore deklaroi:

„Pas këqyrjes në vend dhe vlerësimit të mendimit të ekspertit të gjeodezisë dhe deklaratave të ndërgjyqësve, gjykata ka ardhur në përfundim se e paditura me ndërtimin e rrugës së lagjes, në vendin e quajtur “Vreshta” ka përfshirë në rrugë sipërfaqen e lartcekur të ngastrës 851/8, ashtu që në mënyrë të dukshme ka zvogëluar paluajtshmërinë lëndore të destinuar si truall për ndërtim individual, me çka trualli i paditësit esencialisht ka: humbur funksionin për të cilin është destinuar.

[...] paditësit duke ja marrur 121 m² për qëllime të rrugës, pa lejen e tij dhe pa kurrfarë kompensimi, i ka shkaktuar dëm paditësit në kundërshtim me nenin 16 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, Gaz. Zyr. 29/78, që ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprimeve e që përcakton: “Secili ka për detyrë të rezervohet nga veprimet që mund ti sjellin dëm tjetrit”. Sipas vlerësimit të gjykatës paditësit iu shkaktua dëm me rastin e përfshirjes në rrugë nga e paditura të sipërfaqes së cekur më lartë, që për pasojë pati zvogëlimin dhe humbjen funksionale të destinimit të truallit të paditësit.

Rrjedhimisht duke pasur parasysh faktin se ngastra kadastrale nr. 851/1, pronë e të paditurës nuk ka ndonjë destinim të caktuar, dhe se e njëjta gjendet drejt për së drejti në kufi me ngastrën e paditësit nr. 851/8 gjykata konsideron se ekzistojnë kushtet që pjesa e ngastrës të marrur për rrugën e lagjes ti kompenzohet paditësit nga ngastra 851/1, pasi që me vetë aktin e marrjes së

pjesës së ngastrës që i ka takuar paditësit, e paditura ka hyrë në detyrim ndaj të njëjtit, prandaj gjykata me të drejtë vendosi që ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësit, duke ia njohur atij të drejtën në shfrytëzim të pjesës së ngastrës kadastrale 851/1 në sipërfaqen prej 121 m², që i është marrur nga ngastratrualli i tij për ndërtimin e rrugës së lagjes dhe ta detyroj të paditurën që paditësit t'ia njoh këtë të drejtë”.

30. E paditura Komuna e Prishtinës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit C. nr. 228/11 të Gjykatës Themelore për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të pranohet si e bazuar, që aktgjykimi i kontestuar të anulohet dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim, ose të refuzohet padia si e pabazuar.
31. Më 9 dhjetor 2019, Gjykata e Apelit nxori aktgjykimin AC. nr. 246/2015, përmes të cilit e refuzoi si të pabazuar ankesën e palës së paditur Komunes së Prishtinës, duke vërtetuar aktgjykimin C. nr. 228/11 të Gjykatës Themelore në tërësi.
32. Në arsyetimin e aktgjykimit AC. nr. 246/2015 të Gjykatës së Apelit thuhet:

„[...] e paditura e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetim se me Kontratën për shfrytëzim të tokës ndërtimore, të lidhur në mes të paditësit dhe BVI-së, në nenin 4 paragrafi 2, përcaktohet që përfituesi obligohet që në afat prej 3 vjetësh, pas lidhjes së kontratës, të bëjë ndërtimin përkatësisht ti kryej punimet ndërtimore, për çfarë i është ndarë trualli në shfrytëzim, paditësi nuk i ka bërë këto dhe e ka humbur legjitimacionin, për të kërkuar kompensimin e tokës. Ndërsa, ndërtimin e rrugës e paditura e ka bërë në bazë të planit urbanistik të lagjes.

Gjykata e shkallës së parë mbi bazën e provave të vlerësuara ka ardhë në përfundim se paditësit duke ja marrur 121 m² për qëllime të rrugës, pa lejen e tij dhe pa kurrfarë kompensimi, i ka shkaktuar dëm paditësit në kundërshtim me nenin 16 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, Gaz. Zyr. 29/78, që ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprimeve nga e paditura. Gjykata e shkallës së parë, këtë fakt e konsideron edhe si arsye për të cilën paditësi nuk ka filluar ndërtimin dhe nuk e ka ndërtuar ndërtesën e banimit në pajtim me kushtet dhe afatet e parapara me kontratën për dhënie në shfrytëzim të truallit për ndërtim.

Me dispozitën e nenit 16 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare nr. 29/78) e cila ka qenë në zbatim në kohën e krijimit të këtij raporti juridik civil në mes të paditësit dhe të paditurës, qartë përcaktohet se “secili ka për detyrë të rezervohet nga veprimet që mund ti sjellin dëm tjetrit”. Mirëpo, në rastin konkret e paditura me ndërmarrjen e veprimeve të tilla në ngastrën e paditësit nuk e ka pasur parasysh këtë dispozitë ligjore dhe paditësit i ka shkaktuar dëm duke e penguar atë në përmbushjen e obligimit kontraktues për ndërtimin e ndërtesës banesore, në ngastrën e cila i është dhënë nga e paditura, në shfrytëzim të përhershëm.

Nga gjithë kjo rezulton se, duke u nisur nga fakti i pa kontestueshëm se e paditura për ndërtimin e rrugës së lagjes ka marr një pjesë të sipërfaqes nga trualli i paditësit, atëherë këtë duhet që paditësit t'ia kompensoj duke ia plotësuar me pjesën tjetër të paluajtshmërisë të ngastrës e cila është në afërsi të ngastrës së paditësit e cila është objekt i këtij kontesti, dhe këtë në sipërfaqe prej 121 m²”.

33. Më 31 dhjetor 2019, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Themelore duke kërkuar që Aktgjykimi C. nr. 228/11 i Gjykatës Themelore të 4 korrikut 2014, ka vendosur klauzolën e plotfuqishmërisë. Të njëjtën ditë, Gjykata Themelore lëshoi një urdhërpagesë, duke kërkuar nga parashtruesi i kërkesës që të paguajë tarifën prej 20 euro. Në bazë të shkresave të lëndës, parashtruesi i kërkesës pagoi tarifën e kërkuar, dhe rrjedhimisht, të njëjtën ditë, Gjykata Themelore vendosi një klauzolë të plotfuqishmërisë ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore C. nr. 228/11 të 4 korrikut 2014.
34. E paditura, Komuna e Prishtinës parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 246/2015, të 9 dhjetorit 2019 dhe të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C. nr. 228/2011 të 4 korrikut 2014, duke pretenduar *“shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që revizioni i të paditurës të aprovohet dhe që aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulët të ndryshohen dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditësit ose të anulohen dhe kjo çështje të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë”*.
35. Më 29 qershor 2021, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin Rev. nr. 166/2021, përmes të cilit e ka aprovuar si të bazuar kërkesën për revizion të komunës së paditur të Prishtinës, duke refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.
36. Në arsyetimin e aktgjykimit Rev. nr. 166/2021, Gjykata Supreme konkludoi:

„Gjykata e shkallës së parë ka administruar provat dhe vlerësuar ato duke vërtetuar gjendjen faktike se në mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese fakti se me kontratën për dhënie të tokës ndërtimore në shfrytëzim, paditësit i është dhënë në shfrytëzim të përhershëm paluajtshmëria. Në atë kohë nga kontrata, ka rezultuar se kjo paluajtshmëri i jepet paditësit në shfrytëzim për ndërtimin e ndërtesës së banimit me strukturë P+ 1., dhe është paraparë detyrimi që i njëjti ndërtesë ta ndërtoj në afatin prej 3 vitesh, si dhe obligimin që të njëjtin mos ta tjetërsoj në afatin prej 10 vitesh.

Në arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë, ndër të tjera theksohet se, gjykata me datën 17 prill 2014, kishte dalë në vend shikim dhe nga mendimi i ekspertit të gjeodezisë i datës 25 prill 2014, ka rezultuar se e paditura me rastin e ndërtimit të rrugës së lagjes, pjesën e truallit të paditësit nga ana veri lindore në sipërfaqe prej 90 m², e ka shfrytëzuar për ndërtim të rrugës, kurse pjesa tjetër prej 31 m², ka ngelur në anën e kundërt të rrugës dhe sipërfaqja e tërësishme është prej 121 m², që ishte pjese e truallit të paditësit, kështu që trualli i paditësit apo ngastra lëndore tani nuk mund të shfrytëzohet nga paditësi për ndërtim.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se ngastra kadastrale nr. 851/1, është pronë e të paditurës, e cila nuk ka ndonjë destinim të caktuar dhe është drejtpërsëdrejti në kufi me ngastrën e paditësit nr. 851/8 dhe konsideron se ekzistojnë kushtet që pjesa e ngastrës e cila është marr për rrugën e lagjes të kompensohet paditësit nga ngastra 851/1 [...]

Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se, aktgjykimi i shkallës së parë, nuk është përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe konkludoi se aktgjykimi i atakuar është i qartë [...].

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e vërtetuar kështu, ka ardhur në përfundim se një qëndrim i tillë juridik i gjykatave të instancës më të ulët, nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm [...]. Këtë pikëpamje juridike gjykata e revizionit e mori për bazë nga se është e qartë se e drejta e shfrytëzimit të tokës përmes së cilës nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë ekziston vetëm si e drejtë e shfrytëzimit nën kushtet që i parasheh ligji dhe marrëveshja me pronarin. [...]. Për fitimin e plotfuqishëm të së drejtës për shfrytëzimin mbi paluajtshmërinë në bazë të kësaj pune juridike nënkupton që të plotësohen prezumimet kontraktuale siç janë: në afat prej 3 vitesh duhet të ndërtohet objekti i banimit dhe pas ndërtimit të objektit paluajtshmëria nuk mund të tjetërsohet në afat prej 10 vitesh si dhe mundësia e humbjes së të drejtës së shfrytëzimit në kushte të caktuara.

[...] Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësinë në drejtim të shfrytëzimit të tokës ndërtimore urbane rregullohen në komunë, në atë mënyrë që sigurohen nevojat e ndërtimit dhe rregullimit të hapësirës për punë dhe jetën e njerëzve, për ruajtjen dhe zhvillimin e natyrës, ambientit jetësor dhe interesave tjera të përgjithshme. Nga kjo rrjedh se komuna me pasurinë në pronësi shoqërore e cila është identifikuar në bazë të planit detal urbanistik të qytetit si tokë ndërtimore urbane ka kompetenca dhe autorizime që të administrojnë dhe të disponojnë me tokën ndërtimore e me qëllim të rregullimit të mirëqenies të përgjithshme njerëzore, por gjithnjë për realizimin e nevojave dhe interesave të përgjithshme duke respektuar ruajtjen e hapësirës dhe të natyrës si dhe ambientit jetësor. Këtë gjë e ka bërë e paditura edhe kur i ka ndarë tokën ndërtimore paditësit por edhe kur e ka ndërtuar rrugën.

Në bazë të nenit 4 të kontratës së lidhur në mes të paditësit dhe BVI-së atëherëshme për tokë ndërtimore parashihet se për objektin duhet të merret leje ndërtimi dhe të ndërtohet brenda afatit prej tre vitesh. Sipas nenit 5 të kësaj kontrate, shfrytëzuesi është pajtuar që nëse nuk realizohen obligimet nga kjo kontratë humbet e drejta e shfrytëzimit, ndërsa në rast se nuk është në gjendje të ndërtojë objektin banesor, duhet t'ia kthejë dhënësit token ndërtimore dhe të kërkojë nga Komuna t'ia kompensojë shpenzimet që i ka bërë. Në rastin konkret nuk është realizuar kontrata dhe nuk është përmbushur destinimi i ndërtimit prandaj nuk ka bazë ligjore që për dështimin e shfrytëzimit të tokës ndërtimore sipas destinimit të caktuar të obligohet pronari - e paditura që ta kompensojë për token të cilën e ka dhënë në shfrytëzim dhe e cila ka qenë ende në pronësinë e të paditës dhe se nuk mund të obligohet e paditura që të kompensohet me një ngastër tjetër apo pjesë të saj, pa një marrëveshje të palëve ashtu siç parashihet në nenin V paragrafi 2 i kontratës për dhënie të tokës ndërtimore në shfrytëzim".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

37. Parashtruesi i kërkesës konsideron përmes aktgjykimit të Gjykatës Supreme është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 46 [Mbrotjtja e Pronës], të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
38. Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës konsideron se të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së janë shkelur nga Gjykata Supreme për dy arsye.

- i) Arsyeja e parë, sepse “Gjykata Supreme aprovoi kërkesën për revizion dhe nxori aktgjykimin i cili është marrë në kundërshtim me nenin 211.3 të Ligjit mbi procedurën kontestimore, meqenëse në rastin konkret vlera e kontestit ka qenë 1.000,00 (njëmijë) €, andaj duke u bazuar në nenin 211. 3 të LPK-së, decidivisht është paraparë: Revizioni nuk lejohet në kontestet pasuroro juridike ... , poqëse vlera e objektit të kontestit e treguar në padinë e paditësit nuk kalon shumën prej 3.000.00 (tremijë) €”.
39. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës konsideron se revizioni i palës së paditur Komunes së Prishtinës, i cili është shqyrtuar nga Gjykata Supreme, është dashur të hidhet poshtë si i papranueshëm, duke marrë parasysh se nga shkresat e lëndës rezulton se vlera e kontestit nuk është përcaktuar në padinë e paditësit, dhe paditësi më 31 dhjetor 2019 ka paguar në emër të taksës gjyqësore për padinë e paraqitur, dhe me kërkesë të Gjykatës Themelore në Prishtinë, shumën prej njëzet (20.00) €, që është e barabartë me vlerën e kontestit prej 0 deri në 1.000 (mijë) €. në momentin e vlerësimit gjyqësor kur parashtruesi i kërkesës është ftuar që ta paguajë tarifën gjyqësore.
40. Në mbështetje të kësaj, parashtruesi thekson se padia e parashtruar në gjykatë nuk e përcaktoi vlerën e kontestit dhe deri te Gjykata Supreme kur vendosi për këtë çështje gjykata nuk e pa te arsyeshme që zyrtarisht të përcaktojë vlerën e kontestit edhe pse sipas dispozitës nga neni 36 i Ligjit të procedurës kontestimore, ai e kishte atë detyrim, përkatësisht: “Në qoftë se paditësi nuk e ka përmendur fare vlerën e objektit të kontestit në padinë e paraqitur në gjykatë, apo në qoftë se ai vlerën e tillë e ka caktuar tepër të lartë apo shumë më të vogël se që është ajo realisht, atëherë gjykata sipas detyrës zyrtare, apo sipas prapësimit të palës së paditur, më së voni në seancën përgatitore, e nëse kjo nuk është mbajtur, atëherë në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes juridike, por para se të filloj shqyrtimi i çështjes kryesore, shpejtë dhe në mënyrë të përshtatshme do ta caktoj, përkatësisht do ta verifikojë saktësinë e vlerës së treguar në padi nga paditësi”.
41. Parashtruesi i kërkesës shton se, “ ... lidhur me vlerën e kontestit, gjykata ose sipas “detyrës zyrtare” ose “sipas prapësimit të palës së paditur” por “para se të filloj shqyrtimi i çështjes kryesore” do ta verifikoj saktësinë e vlerës së treguar në padi nga paditësi. Në rastin konkret gjatë gjithë procedurës së zhvilluar nuk ka qenë e përcaktuar vlera e objektit të kontestit. Kjo nuk ishte kontestuar as ex-officio nga ana e gjykatës e as nga ana e të paditurës Komunes së Prishtinës dhe në këtë mënyrë çështja përfundoj nga ana e të gjitha instancave gjyqësore pa u përcaktua shuma e objektit të kontestit. Prandaj pavarësisht se sa ishte ajo shumë në realitet ajo duhej korrigjuar gjer në fillimin e shqyrtimit të çështjes kryesore gjë që nuk është bërë. Dhe i vetmi vlerësim është bërë me dt. 31.12.2019 kur nga parashtruesi i kërkesës gjykata kërkon të paguhet taksa në lartësi prej 20.00 €”.
42. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme nuk ka pasur të drejtë të procedojë revizionin e palës së paditur në këtë kontest, Komunës së Prishtinës, pasi që revizioni ka qenë i palejueshëm.
43. Parashtruesi i kërkesës në mbështetje të bazueshmërisë së pretendimeve të tij, dorëzoi në Gjykatë në shkresat e lëndës një sërë vendimesh të Gjykatës Supreme, përkatësisht vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë në rastin Rev. nr. 55/2020, të 05.11.2020 për hedhjen e revizionit të palës paditëse si të palejueshëm për shkak të vlerës së kontestit, vendimin Rev. nr. 411/2021 të 14.10.2021 për hedhjen poshtë të revizionit si të palejueshëm edhe të palës paditëse për shkak të vlerës së kontestit,

vendimin Rev. nr. 137/2013 të 08.10.2013, me të cilin aktvendim është hedhur poshtë si i palejueshëm revizioni i paditësit për shkak të vlerës së kontestit, aktvendimin Rev. nr. 213/2015 të 22.07.2015, me të cilin gjithashtu u hodh poshtë revizioni i të paditurit si i palejueshëm për shkak të vlerës së kontestit.

44. Rrjedhimisht, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, “*duke ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C. nr. 228/11 të dt. 04.07.2014 dhe atë të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë Ac. nr. 246/2015 të dt. 09.12.2019 dhe duke refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, pa e vlerësuar lejueshmërinë e revizionit Gjykata Supreme ka shkelur parimin e sigurisë juridike dhe ja ka mohuar parashtruesit të kërkesës një gjykim të drejtë dhe të paanshëm lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tij brenda kuptimit të nenit 31 paragrafi 2 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së*”.

ii) Si arsye e dytë për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës përmend faktin se Gjykata Supreme nuk e ka njoftuar atë, dhe as përfaqësuesin e tij, lidhur me kërkesën për revizion të parashtruar nga e paditura.

45. Prandaj, parashtruesi i kërkesës konsideron se është më se logjike që procedura kontestimore nuk ka mundur të zhvillohet në mes të dy subjekteve, njëri prej të cilëve nuk ka marrë pjesë në seancë, përkatësisht nuk i është mundësuar të njoftohet lidhur me pretendimet e palës kundërshtare, konkretisht, me mjetin juridik të parashtruar nga pala kundërshtare dhe vendimi i gjykatës të jetë në dëm të saj. Një akt i tillë përbën shkelje drastike të të drejtave të njeriut, në veçanti nenit 6 (1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili thotë, citoj: “*Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht...në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.... nga ... (një) gjykatë*” e për më tepër është shkelur neni 31 i Kushtetutës së Kosovës, pastaj neni 53 (Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut) i Kushtetutës, i cili përcakton: “*Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*”.
46. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, me vendimin e saj të kontestuar, ka shkelur të drejtën për mbrojtjen e pronës dhe të drejtën për barazi para ligjit, të garantuara me nenin 46, përkatësisht nenin 24 të Kushtetutës, si dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, por se ai nuk jep shpjegime të veçanta në mbështetje të këtyre pretendimeve.
47. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesën; *Të konstaton se ka pasur shkelje të nenit 24 dhe 46 (Mbrojtja e pronës) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 1 (E drejta e pronës) të protokollit 1 të KEDNJ-së, se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, të shpallë të pavlefshëm (shfuqizojë) Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë Rev. nr. 166/2021 të dt. 29.06.2021, të konstatoj se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë Ac. nr. 246/2015 të dt. 09.12.2019 dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C. nr. 228/11 të dt. 04.07.2014, janë përfundimtar dhe të detyrueshëm, dhe si të tillë res judicata*”.

Përgjigja e përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës së 15 prillit 2022, lidhur me kërkesën për shpjegim shtesë të Gjykatës, të 7 prillit 2022

48. Gjykata rikujton se më 7 prill 2022, dërgoi një shkresë plotësuese përfaqësuesve të parashtruesit të kërkesës, duke kërkuar sqarime lidhur me pretendimet përkatëse që ata bënë në kërkesë. Konkretisht, pyetja e Gjykatës ishte: *“A keni dorëzuar përgjigje në revizionin e parashtruar nga Komuna e Prishtinës në Gjykatën Supreme, nëse po, ju lutemi të na dorëzoni”*.
49. Më 15 prill 2022, përfaqësuesit e parashtruesit të kërkesës i dërguan Gjykatës përgjigjen përmbajtje si në vijim:

“[...]”

Siç kemi deklaruar në paragrafin 15 të kërkesës së dorëzuar, një kopje e këtij revizioni është dashur t'i dorëzohet palës kundërshtare, në këtë rast avokatit të parashtruesi të kësaj kërkeje, avokatit të tij i cili ka qenë i angazhuar gjatë gjithë procedurës, z. Avdi Ahmeti (shih nenin 219, paragrafi 1 i Ligjit për procedurën kontestimore, i cili parasheh se një kopje e revizionit të dorëzuar me kohë dhe që është plotësisht i lejuar, gjykata e shkallës së parë në afat prej shtatë ditësh ia dërgon palës kundërshtare, e cila në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, si palë kundërshtare ka të drejtë të paraqesë përgjigje në revizion gjykatës së shkallës së parë brenda shtatë ditëve nga dita kur i është dorëzuar revizioni). Megjithatë, një kopje e këtij revizioni nuk i është dorëzuar as parashtruesit të kërkesës dhe as avokatit të tij.

Fletëkthesa, e cila gjendet në shkresat e lëndës se ai, si përfaqësues i këtu propozuesit ka pranuar një kopje të revizionit të dorëzuar nga Komuna e Prishtinës më 24 shkurt 2021, është dokument i keqpërdorur (i falsifikuar), sepse përfaqësuesi, këtu i propozuesit insiston se nuk ka pranuar fare një kopje të revizionit nga Gjykata Komunale në Prishtinë, duke sqaruar se në atë kohë nuk ka punuar për shkak të shëndetit shumë të dobët (vështirësi në ecje, dobësim i sistemit muskulator të këmbëve, ndjesi shpimi gjilpërash në duar dhe këmbë, lodhje dhe dërrmim, për ç'arsye ai është shtruar tri herë në QKUK nga 19.02.2020 deri më 12.03.2020, pastaj nga 22.01.2021 deri më 25.01.2021 dhe nga 18.03.2021 deri më 23.03.2021).

Në deklaratën e tij, përfaqësuesi i propozuesit që e ka përfaqësuar në këtë kontest thekson se nga fletëkthesa e dorëzimit personal shihet qartë se nuk është nënshkrimi i tij dhe se në këto shkresa të lëndës C. nr. 228/11 shihen nënshkrimet e tij si përfaqësues i autorizuar, nga padia, procesverbali gjyqësor, përgjigja në ankesë dhe në shkresa të tjera..“

50. Në mbështetje të përgjigjes së tij, përfaqësuesit e parashtruesit të kërkesës kanë dorëzuar gjithashtu një deklaratë me shkrim të përfaqësuesit të mëparshëm të parashtruesit të kërkesës, avokatit A.A nga Prishtina, në të cilën ai mohoi se kishte pranuar revizionin e dorëzuar nga Komuna e Prishtinës, duke deklaruar arsye shëndetësore.

Dispozitat ligjore përkatëse

Ligji nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-118

“Neni 36

“Në qoftë se paditësi nuk e ka përmendur fare vlerën e objektit të kontestit në padinë e paraqitur në gjykatë, apo në qoftë se ai vlerën e tillë e ka caktuar tepër të lartë apo shumë më të vogël se që është ajo realisht, atëherë gjykata sipas detyrës zyrtare, apo sipas prapësimit të palës së paditur, më së voni në seancën përgatitore, e nëse kjo nuk është mbajtur, atëherë në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes juridike, por para se të filloj shqyrtimi i çështjes kryesore, shpejtë dhe në mënyrë të përshtatshme do ta caktoj, përkatësisht do ta verifikojë saktësinë e vlerës së treguar në padi nga paditësi. Në rast të këtillë gjykata vendosë me aktvendim kundër të cilit nuk lejohet ankimi.
[...]

Neni 211

[...]
211.3 Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia nuk ka të bëjë me kërkesat në para, me dorëzimin e sendit apo me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit e treguar në padinë e paditësit nuk e kalon shumën prej 3.000 Euro.
[...]

Neni 218

1. Revizionin e paraqitur pas skadimit të afatit ligjor, apo atë jo të plotë, me anë të aktvendimit e hedhë poshtë gjykata e shkallës së parë, pa mbajtur seancë gjyqësore:

- a) e ka paraqitur personi i cili nuk është i autorizuar për paraqitjen e revizionit;*
- b) revizionin e ka paraqitur personi i cili e ka tërhequr revizionin;*
- c) nëse personi i cili ka paraqitur revizionin nuk ka interes për paraqitjen e tij;*
- d) është paraqitur revizioni kundër aktgjykimit kundër të cilit sipas ligjit nuk mund të paraqitet..*

Neni 219

219.1 Një ekzemplar të revizionit të paraqitur me kohë dhe që është i plotë dhe i lejueshëm, gjykata e shkallës së parë, brenda afatit shtatë ditor, ia dërgon palës kundërshtare.

219.2 Pala kundërshtare ka të drejtë që, brenda afatit shtatë ditor, nga dita në të cilën i është dorëzuar revizioni, në gjykatën e shkallës së parë ta paraqes përgjigjen në revizion.

219.3 Pasi të arrijë përgjigja në revizion apo pas skadimit të afatit për përgjigje, revizionin dhe përgjigjen, nëse është paraqitur, gjykata e shkallës së parë ia dërgon gjykatës së revizionit, bashkë me dosjen e lëndës, brenda afatit shtatë ditor, nëpërmjet gjykatës së shkallës së dytë.
[...]

Neni 221

Revizionin e vonuar, jo të plotë dhe të palejueshëm me, aktvendim e hedhë poshtë gjykata e revizionit, po që se një gjë të tillë nuk e ka bërë gjykata e shkallës së parë brenda kufijve të autorizimeve të saja (neni 218 i këtij ligj).

[...]

Pranueshmëria e kërkesës

51. Gjkata fillimisht shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

52. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

53. Gjykata gjithashtu i referohet më tej kriterëve të pranueshmërisë, siç përcaktohen në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor[...].”

54. Sa i përket plotësimit të këtyre kushteve, Gjykata së pari konstaton se parashtruesi I kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev. nr. 166/2021 të 29 qershorit 2021. Parashtruesi i kërkesës po ashtu theksoi të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me kushtet e nenit 48 të Ligjit dhe e parashtroi kërkesën e tij në përputhje me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

55. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, vlerësimit nëse kërkesa është e pranueshme apo qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtoj thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të

nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

56. Në lidhje me këtë, duke pasur parasysh se rasti në fjalë ka karakter të procedurës kontestimore, Gjykata do të vlerësojë kushtet procedurale të pranueshmërisë në kontekstin e shterimit të mjeteve juridike të përdorura nga parashtruesi i kërkesës për të realizuar të drejtat e tij pronësore.
57. Prandaj, në bazë të parimeve të përgjithshme në lidhje me shterimin e mjeteve juridike, siç shtjellohen në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por dhe e Gjykatës, Gjykata së pari do të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Të njëjtat parime janë shtjelluar nga Gjykata në mënyrë të hollësishme në një numër të caktuar të rasteve, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet KI108/18, parashtrues *Blerta Morina*, Aktvendim për papranueshmëri i 30 shtatorit 2019; KI147/18, parashtrues *Artan Hadri*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 tetorit 2019; KI211/19, parashtrues *Hashim Gashi, Selajdin Isufi, B.K., H.Z., M.H., R.S., R.E., S.O., S.H., H.I., N.S., S.I., dhe S.R.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 nëntorit 2020; KI43/20, parashtruese *Fitore Sadikaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 31 gushtit 2020; dhe KI42/20, parashtrues *Armend Hamiti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 31 gushtit 2020.
58. Rrjedhimisht, Gjykata fillimisht i referohet kushteve të pranueshmërisë siç përcaktohen me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht i referohet nenit 47 (Kërkesat individuale) të ligjit, i cili përcakton:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

59. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe rregullit 39 (1) (b) dhe (2) të Rregullores së punës, i cili parasheh,

(1) “Gjykata mund ta konsideroj një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar”

60. Në mënyrë që Gjykata të vlerësojë nëse kërkesa e parashtruar i plotëson kushtet procedurale për procedim të mëtejshëm, ajo duhet të rikujtojë thelbin e procedurës gjyqësore të iniciuar dhe zhvilluar nga parashtruesi i kërkesës, si dhe të përcaktojë nëse ai duke ndjekur rrugën procedurale në kohën e duhur i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike në dispozicion pranë autoriteteve gjyqësore përkatëse.
61. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore dhe të Apelit e ka ushtruar të drejtën pronësore të cilën e ka kërkuar në kërkesëpadi, por që para Gjykatës Supreme, sipas pretendimeve të tij, ai e ka humbur atë të drejtë pronësore në mënyrë të kundërligjshme për faktin se; *i) “Gjykata Supreme aprovoi*

kërkesën për revizion dhe nxori aktgjykimin i i cili është marrë në kundërshtim me nenin 211.3 të Ligjit mbi procedurën kontestimore, meqenëse në rastin konkret vlera e kontestit ka qenë 1.000,00 (njëmijë) €, andaj duke u bazuar në nenin 211.3 të LPK-së, decidivisht është paraparë: Revizioni nuk lejohet në kontestet pasuroro juridike ... ,poqëse vlera e objektit të kontestit e treguar në padinë e paditësit nuk kalon shumën prej 3.000.00 (tremijë) € “, dhe **ii**) Gjykata Supreme nuk e ka njoftuar atë, dhe as përfaqësuesin e tij, lidhur me kërkesën për revizion të parashtruar nga e paditura komuna e Prishtinës”.

62. Duke marrë parasysh se pretendimet e parashtruesit kërkojnë “vëmendje” të veçantë, Gjykata vendosi të ndërmarrë një sërë veprimesh procedurale, të gjitha me qëllim të eliminimit të të gjitha dyshimeve që Gjykata i konsideroi pamjaftueshëm të qarta ose më pak të argumentuara në kërkesë. Rrjedhimisht, më 22 mars 2022, Gjykata i dërgoi një shkresë Gjykatës Themelore duke kërkuar që asaj t’i dorëzohen të gjitha shkresat e lëndës lidhur me këtë rast, gjë që Gjykata Themelore e bëri më 28 mars 2022. Pas një analize të hollësishme të përmbajtjes së shkresave të lëndës, Gjykata gjeti fletëkthesën, në bazë të së cilës rezulton se përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës, avokati A.A., nënshkrimi i të cilit është në fletëkthesë, ka pranuar revizionin e parashtruar nga Komuna e Prishtinës në Gjykatën Supreme më 24 shkurt 2021. Për analizën e mëtutjeshme të shkresave të lëndës, Gjykata nuk gjeti përgjigjen nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës në revizionin e dorëzuar të Komunës së Prishtinës.
63. Në mbështetje të atij fakti, Gjykata më 7 prill 2022, dërgoi një shkresë plotësuese përfaqësuesve të parashtruesit të kërkesës, me pyetjen “A keni dorëzuar përgjigje në revizionin e parashtruar nga Komuna e Prishtinës në Gjykatën Supreme, nëse po, ju lutemi të na dorëzoni”.
64. Përgjigjia e përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës është pranuar nga Gjykata më 15 prill 2022, në bazë të përmbajtjes të së cilës mund të nxirren përfundimet në vijim; **a**) se përfaqësuesi i mëparshëm i parashtruesit të kërkesës nuk e ka pranuar revizionin e Komunës së Prishtinës, **b**) se në kohën e dorëzimit të pretenduar të revizionit, përfaqësuesi i mëparshëm i parashtruesit të kërkesës kishte probleme shëndetësore, **c**) se revizioni nuk i është dorëzuar as parashtruesit të kërkesës. Sa i përket fletëkthesës, e cila qartazi gjendet në shkresat e lëndës, Gjykata ka vërejtur nga përgjigja e përfaqësuesit të parashtruesit se ai e ka lidhur ekzistencën e saj me falsifikim, përkatësisht përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës në përgjigje pretendon se “është dokument i keqpërdorur (i falsifikuar), sepse përfaqësuesi, këtu i propozuesit insiston se nuk ka pranuar fare një kopje të revizionit nga Gjykata Komonale në Prishtinë...”
65. Duke pasur parasysh gjendjen faktike në shkresat e lëndës, si dhe argumentet e paraqitura nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës, Gjykata vlerëson se dëshmitë me shkrim në shkresat e lëndës ishin më të rëndësishme për rastin konkret, pasi bëhej fjalë për gjendjen faktike në shkresat e lëndës, që si të tillë, Gjykata nuk mund ta injorojë, edhe pse Gjykata gjithashtu mori parasysh pretendimet e avokatit të parashtruesit të kërkesës në lidhje me “dokumentin e keqpërdorur (falsifikuar), “.
66. Rrjedhimisht, së pari, Gjykata është e mendimit se fakti i thjeshtë i ekzistimit të provës materiale në shkresat e lëndës për dorëzimin e revizionit përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës më 24 shkurt 2021, i cili si i tillë nuk është në favor të parashtruesit të kërkesës, shpie në përfundimin; **i**) që përfaqësuesi i mëparshëm i parashtruesit të kërkesës e ka pranuar në mënyrë të rregullt njoftimin për revizionin e dorëzuar të Komunës së Prishtinës në Gjykatën Supreme, **ii**) se përfaqësuesi i

mëparshëm i parashtruesit të kërkesës e ka humbur mundësinë për t'iu përgjigjur atij. Për më tepër, një mosveprim apo lëshim i tillë i përfaqësuesit të mëparshëm të parashtruesit të kërkesës ka krijuar një situatë ligjore që ai në kohën adekuate nuk ka ofruar përgjigje në ankesën e paraqitur në Gjykatën Supreme, dhe një mosveprim i tillë mund të konsiderohet si heqje dorë vullnetare që në procedurën në Gjykatën Supreme me mjete të rregullta juridike konteston revizionin e dorëzuar të Komunës së Prishtinës, si në aspektin material ashtu edhe në atë procedural.

67. Bazuar në këtë, rezulton se përfaqësuesi i mëparshëm i parashtruesit të kërkesës e ka humbur mundësinë për të shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike në kuptimin procedural në procedurën e kontestimit të revizionit të parashtruar të Komunës së Prishtinës në Gjykatën Supreme.
68. Gjykata rikujton se rregulli për shterimin e mjeteve juridike sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës i obligon ata që dëshirojnë të paraqesin rastin e tyre në Gjykatën Kushtetuese që së pari të shfrytëzojnë mjetet juridike efektive në dispozicion në pajtim me ligjin, kundër një aktgjykimi apo vendimi të kontestuar.
69. Në këtë mënyrë, gjykatave të rregullta u jepet mundësia që të korrigjojnë gabimet e tyre gjatë procedurës së rregullt gjyqësore para se çështja të vijë në Gjykatën Kushtetuese. Ky rregull bazohet në supozimin e shprehur në nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së, që në legjislacionin vendës ka mjete juridike në dispozicion për t'u shfrytëzuar pranë gjykatave të rregullta në lidhje me shkeljen e pretenduar pavarësisht nëse dispozitat e KEDNJ-së janë inkorporuar në ligjin kombëtar apo jo (shih, *inter alia*, Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Aksoy kundër Turqisë*, Kërkesa nr. 21987/93, i 18 dhjetorit 1996, paragrafi 51).
70. Parimi është se mekanizmi mbrojtës, i krijuar nga Gjykata Kushtetuese të jetë subsidiar në raport me sistemin e rregullt gjyqësor që mbron të drejtat e njeriut (shih, ndër të tjera, Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, i 7 dhjetorit 1976, Kërkesa nr. 5493/72, paragrafi 48).
71. Në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të ketë mundësi të shfrytëzojë mjetet juridike të cilat janë në dispozicion dhe të mjaftueshme për të siguruar një mundësi për të korrigjuar shkeljet e pretenduara. Ekzistimi i mjeteve juridike në fjalë duhet të jetë mjaft i sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, dhe nëse nuk është kështu, atëherë këtyre mjeteve juridike do t'iu mungojë disponueshmëria dhe efektiviteti i nevojshëm (shih, *inter alia*, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Vernillo kundër Francës*, kërkesa nr. 11889/85, i 20 shkurtit 1991, paragrafi 27; dhe Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Dalia kundër Francës*, kërkesa nr. 154/1996/773/974, i 19 shkurtit 1998, paragrafi 38 i).
72. Para përfundimit në lidhje me shqyrtimin e kësaj kërkesë, Gjykata dëshiron të shtojë se ajo gjithashtu ka marrë parasysh edhe pretendimin e përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës "*se fletëkthesa për dorëzimin e revizionit me nënshkrimin e përfaqësuesit të mëparshëm është në fakt falsifikim*", dhe rrjedhimisht Gjykata dëshiron të ritheksojë se nuk është Gjykatë që merret me vërtetimin e fakteve, më konkretisht kjo Gjykatë nuk merret me shqyrtimin nëse një provë është e falsifikuar apo jo, kjo është në kompetencë të organeve të tjera. Në mbështetje të kësaj, Gjykata thekson se nëse përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës konsideron se një dokument kaq i rëndësishëm është i falsifikuar dhe se ai ka prova materiale në mbështetje të këtij pretendimi, atëherë asgjë nuk e pengon atë që t'i mbrojë të drejtat e tij duke iu

drejtuar organeve kompetente, të cilat do të shqyrtonin në mënyrë adekuate bazueshmërinë e pretendimeve të tij.

73. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit është e papranueshme në baza kushtetuese, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, parashihet në nenin 47 të Ligjit dhe specifikohet më tej në rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 8 qershor 2022, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TUA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka Nimani